



Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit për Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Më 25 tetor 2005, në Athinë të Greqisë u NËNSHKRUA TRAKTATI që themelon Komunitetin Energjetik në Evropën Juglindore. Shefi i ZRRE-së mori pjesë në ceremoninë nënshkruese të Traktatit, së bashku me Zv./PSSP-në Z. Joachkim Ruecker dhe Zëvendës Ministrin e MEM-it Z. Agron Dida. Me anë të nënshkrimit të këtij Traktati, Kosova përkushtohet që të pajtohet me Legjislacionin Evropian në sektorin energjetik, si dhe të promovojë konkurrencën e bazuar në parimet e tregut të lirë.

Fjala hyrëse nga Kryesuesi

Viti 2004 ka qenë një moment historik për përcaktimin e zhvillimeve të ardhshme në Sektorin Energjetik në Kosovë.

Miratimi i Ligjeve mbi "Energjinë", "Energjinë Elektrike" dhe "Rregullatorin e Energjisë" nga ana e Kuvendit dhe më pas shpallja e tyre nga ana e PSSP-së, përcaktojnë kornizën për krijimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm, i cili garanton sigurinë e furnizimit për të gjithë qytetarët e vet, dhe përforcon rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Pas shpalljes së Ligjeve të sipërpërmendur të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, UNMIK-u më 30 qershor 2004 themeloi Zyrën e Rregullatorit të Kosovës (ZRRE), si një Autoritet i pavarur.

Në vitin e vet të parë të funksionimit, ZRRE-ja është fokusuar në fitimin e aftësive teknike, ekonomike dhe ligjore që nevojiten për të hartuar dhe menaxhuar me sukses sistemet rregullatore për industrinë energjetike. ZRRE-ja është plotësisht e vetëdijshme për sfidat e shumta me të cilat përballet në sektorin energjetik në Kosovë, dhe në veçanti me pozicionin e dobësuar financiar të ndërmarrjeve, dhe si prioritet parësor është vënë ndihma dhe stabilizimi i tyre.

Përveç këtyre përpjekjeve, ZRRE-ja gjatë vitit 2004 ka ndërmarrë një shqyrtim të përgjithshëm të çmimeve në sektorin e Ngruhjes Qendrore dhe ka arritur të zbrësë çmimet me një mesatare prej 12%.

Me ndihmën e konsulentëve pjesa kryesore e punës u përqendrua në përgatitjen e legjislacionit dytësor. Stafi i ri i ZRRE-së gjatë vitit 2004, ka ndërmarrë përpjekje të jashtëzakonshme dhe ka bërë arritje të mëdha duke u nisur nga një kthese e rrëpirë e të mësuarit.

Dëshiroj të falënderoj kolegët e mi për përpjekjet e tyre të suksesshme, tashmë të komentuar pozitivisht prej palëve të tjera të interesuara, dhe uroj që të kemi vetëbesim ndaj sfidave madhore me të cilat ZRRE-ja përballet gjatë 2005-ës.



Nick F Frydas



Krijimi i Bordit të ZRRE-së

Gusht 2005

Pas emërimit nga ana e PSSP-së të dy Anëtarëve të fundit të Bordit të ZRRE-së, Bordi tashmë është plotësisht i formuar dhe ka mbajtur mbledhjen e tij të parë.

Roli i ZRRE-së

Detyra kryesore e ZRRE-së është që të krijojë kushtet për një furnizim të qëndrueshëm me energji, të sigurtë dhe të shëndetshëm nga ana ambientale, si dhe të promovojë, krijojë dhe mbrojë një treg konkurrues energjetik në Kosovë, të bazuar mbi parimet e objektivitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit.



Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë përcakton pushtetin, detyrat dhe funksionet e ZRRE-së për të zhvilluar kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve energjetike, procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizimin me energji.

Rregullimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik duke lehtësuar strukturën e duhur institucionale dhe organizative që duhet të vendoset në mënyrë që të tërheqë investime masive private të cilat nevojiten për të shfrytëzuar burimet racionale natyrore.



Çështjet Madhore në Sektorin Energjetik

- Ristrukturimi dhe inkorporimi i ndërmarrjeve energjetike në përputhje me Direktivat e BE-së (kjo detyrë është monitoruar nga ZRRE-ja dhe është shumë e rëndësishme për zhvillimin e sektorit në lidhje me palët e tjera të interesuara: AKM dhe MEM)

- Zhvillimi i tregjeve të liberalizuara të energjisë në përputhje me kriteret e traktatit të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore (ECSEE). Kjo do të stimulojë projekte të reja investimesh në sektorin energjetik të financuar nga investitorët privatë.

- Krijimi i kornizës ligjore për hyrjen e re në Sektorin Energjetik i cili lejon pjesëmarrje konkurruese të Kosovës në tregjet rajonale të energjisë (energji elektrike dhe gaz) në Evropën Juglindore.

**Legjislacioni Dytësor I
Zhvilluar dhe Aprovuar nga
ZRRE-ja (miratuar nga
Bordi)**

15 Dhjetor 2005

- **Statuti i ZRRE-së**
- **Kodi i Etikës dhe Sjelljes**
- **Rregulli mbi Çmimet**
- **Metodologjia e Tarifave**

**Rregullat që i nënshtrohen
Procedurave të Konsultimit
Publik**

Draftet e botuar dhe komentet e
diskutuara në Dëgjimet Publike

- **Rregulli mbi Licencimin**
- **Pasqyra e Taksave**
- **Rregulli mbi Procedurat e
Zgjdhjes së Mosmarrëveshjeve**
- **Rregulli mbi Shkëputjen**
- **Termet dhe Kushtet e
Përgjithshme për Furnizimin me
Energji**
- **Rregulli mbi Fshehtësinë e
Informacionit**
- **Rregulli mbi Autorizimin**
- **Rregulli mbi Regjistrin Publik**
- **Doracaku i Punës**

Rregullat e mësipërme planifikohen
të miratohen gjatë Janar-Mars 2006

Vendimet e nxjerra nga ZRRE-ja

Vendimi D_02_2004,
Tarifat e Ngrohjes Qendore për Termomint
për sezonin 2004-2005

Vendimi D_01_2005, Aprovimi i Kriteveve
për përcaktimin dhe përlogaritjen e
shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë
elektrike

Vendimi D_02_2005,
Mbi aprovimin e Kërkesës së KEK-ut në
lidhje me Procedurat e Shkëputjes

Vendimi D_03_2005,
Mbi Procedurat Lidhëse dhe çmimet

Vendimi D_04_2005,
Mbi aprovimin e Tarifave të Ngrohjes për
KNQ "Gjakova" për vitin 2005-2006

Vendimi D_05_2005,
Mbi aprovimin e Tarifave të Ngrohjes për
KNQ "Termokos" për vitin 2005-2006

Vendimi D_06_2005,
Mbi aprovimin e Tarifave të Ngrohjes për
PMU Standard/ NjNQ "Termomit" për vitin
2005-2006

Vendimi D_07_2005
Mbi aprovimin e Tarifave të Ngrohjes për
KNQ "Zvecan" për vitin 2005-2006

Vendimi D_08_2005,
Mbi aprovimin e Kërkesës së KEK-ut në
lidhje me "Politikën ABC"

Udhëzimi i Përkohshëm I_02_2005 mbi
Parimet e Përlogaritjes së Tarifave dhe
Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore
për Sezonin Ngrohës 2005/2006.

Udhëzimi i Përkohshëm I_01_2005 mbi
Raportimin e Ndërmarrjeve të Ngrohjes
Qendrore tek Rregulatori.



Pjesëmarrja e ZRRE-së në Konferencat, Mbledhjet, Workshop-et, Seminaret, Ndërkombëtare, etj.

- GP CEER-SEEER në Romë, *Shkurt 2005*.
- Konferenca e 5-të Vjetore e ERRA-s në Budapest, *Prill 2005*
- *Takimi i parë i ECRB në Athinë, Maj 2005*.
- *GP CEER-SEEER në Sofje, Maj 2005*.
- *Java e Energjisë në Shkup, Qershor 2005 (Forumi i 6-të i Athinës)*.
- *Takimi i Parë i Grupit Rregullator të gazit ECSEE (Zagreb, Kroaci), 2005*.
- "Mini-Forumi" i parë i EJL dhe seminari mbi Monitorimin e Tregut, Athinë-Greqi, *Tetor 2005*.
- *Takimi i GP-së së SETSO-s në Venecia, Nëntor 2005*.
- *Java e Energjisë në Beograd, Nëntor 2005 (Forumi i 7-të i Athinës)*.
- *Trajnimi mbi Ngrohjen Qendrore, Vilnius- Lituani, Dhjetor 2005*
- *Udhëtim Studimi në Portugali, Qershor 2005*.
- *Takimi i SC-së mbi Studimin e Fizibilitetit për Linjën Ndërlidhëse 400 kV Kosovë-Shqipëri në Tiranë, Gusht, 2005*
- *Java e Energjisë në Athinë, Nëntor 2004 (Forumi i 5-të i Athinës)*.
- *Konferenca Ballkanike mbi Energjinë Sofje- Bullgari, Shtator, 2005*
- *Komiteti mbi Tarifat/Çmimet i ERRA-s në Jerevan-Armeni, Shtator 2005*
- *Komiteti Ligjor dhe i Licencave i ERRA-s, Shën Peterburg, Shtator 2005*
- *Komiteti Ligjor dhe i Licencave i ERRA-s, Kiev-Ukrahinë, Tetor 2005*
- *Kursi pilot online i ERRA-s mbi Rregullimin Energjetik, Tetor 2005*
- *Pjesëmarrja Publike & Workshopi mbi Komunikimin i ERRA-s, Kiev-Ukrahinë, Tetor 2005*
- *Trajnimi mbi Ngrohjen Qendrore, Malmo- Suedi, Nëntor 2005*
- *Trajnimi mbi Energjinë e Pandërprerë dhe Thëngjillin e Pastër (SHBA), Nëntor 2005*.
- *Konferenca e IEE-së mbi Tregëtimin e Energjisë, Londër -MB, Nëntor 2005*

Stafi i ZRRE-së në vitin 2004

